



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 93, datë 26.07.2021

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 3, 5, 6, BASHKIA DURRËS, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit”, i ndryshuar, të raportit të Komisionit të Posaçëm, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,


KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i procesit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative 3, sipas aneksit 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i procesit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative 5, sipas aneksit 2 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i procesit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative 6, sipas aneksit 3 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Miratimin e raportit me nr. 943/29 prot., datë 23.06.2021 të Komisionit të Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i procesit të rindërtimit të banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019 në Njësitë Administrative 3, 5, 6, Bashkia Durrës, bashkëlidhur.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi





U shpall sot me datë 26.07.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. 943 / Prot.
29

Durrës, më 23 . 07 . 2021

MIRATOI
ZËVENDËSKRYETAR
Emirjana Sako

RAPORT

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR.6, NR. 5 NR. 3 BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.

E nderuar zëvendëskryetare,

Sikurse jeni në dijeni, tërmeti i fuqishëm i rënë në datën 26.11.2019, që tronditi Shqipërinë, përfshiu edhe territorin administrativ të Bashkisë Durrës, ku janë evidentuar dëme të shumta ndërtimore në të gjitha Njësitë Administrative në juridiksionin administrativ të saj. Nisur nga kjo ngjarje natyrore, e cila krijoi një situatë të papritur me pasojë të rënda për banorët e Bashkisë Durrës, duke cënuar sigurinë e tyre dhe shkaktuar dëme të mëdha për jetën e njerëzve, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, në të cilin ishte sanksionuar fakti se për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, institucionet publike ishin të detyruara të merrnin masa të jashtëzakonshme për përballimin e kësaj shtate. Konkretisht, referuar pikës 7.1, shkronjat “a” dhe “d” institucionet publike duhej të realizonin plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e saj.

Në vijim, Këshilli i Ministrave, me qëllim intensifikimin e masave dhe veprimeve për përballimin e pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore, si edhe të fatkeqësive të tjera që për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, miratoi Aktin Normativ nr. 9, datë datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, i cili, ka si objekt kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Në zbatim të këtyre parashikimeve dhe në funksion të fillimit të zbatimit të programeve të procesit të rindërtimit, Këshilli i Ministrave miratoi një sërë aktesh në zbatim të Aktit Normativ, në të cilat u detajuan procedurat që duhet të ndiqen për secilin prej programeve, nga të cilat, më të rëndësishmet mund të përmendim vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar.

Vendimet e sipërcituara, krahas përcaktimit të procedurave dhe rregullave për të përfituar nga disa prej programeve të lartpërmendura, parashikojnë detyrimin e kryetarit të bashkisë për ngritjen e Zyre të Posaçme të Rindërtimit për shqyrtimin e dosjeve dhe kualifikimin e tyre si dhe ngritjen e një Komisioni të Posaçëm që do të vlerësojë dhe shqyrtojë aplikimet për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit. Më specifikisht, detyrat konkrete të komisionit janë të përcaktuara në pikat e poshtëshënuara:

- Pika 8, e VKM-së nr. 904/2019: Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave përmban informacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si mëposhtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e kërkesës; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit; d) adresën e kërkuarit; dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) Aktin e konstatimit/akt ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëme tëqë ka pësuarndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme; ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt përfitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

- Pika 16, e VKM-së nr. 904/2019: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.

- Pika 21, e VKM-së nr. 5/2020: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi.”.

Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile, i ngritur me urdhër nr. 108, datë 12.03.2020 të Zëvendëskryetarit të Bashkisë, ka kryer shqyrtimin dhe kualifikimin e dosjeve të pronarëve të banesave, shtëpi individuale.

Ky dokumentacion dhe kjo listë e subjekteve përfituese i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm nga Zyra e Posaçme e Rindërtimi, nëpërmjet:











1. Raportit nr. 943/27 prot. datë 22.07.2021 për banesat individuale të dëmtuara në Njësinë nr. 5, ku kanë kualifikuar 1 subjekte përfituese, ku të gjitha subjektet kanë aplikuar në platformën “Shtëpia Ime”.
2. Raportit nr. 943/28 prot. datë 22.07.2021 për banesat individuale të dëmtuara në Njësinë Administrative NR. 6, ku kanë kualifikuar 2 subjekte përfituese, ku të gjitha subjektet kanë aplikuar në platformën “Shtëpia Ime”.
3. Raportit nr. 943/26 prot. datë 22.06.2021 në Njësinë Administrative NR. 3 ku kanë kualifikuar 1 subjekte përfituese (Riforcim) subjekti ka aplikuar në platformën “Shtëpia Ime” .

Kjo listë e subjekteve përfiton nga programi i procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, lista e subjekteve përfituese, pjesë përbërëse e këtij relacioni, është si:

- Anekset në Njësitë Administrative nr.6,nr.5,nr.3

KOMISIONI I POSAÇËM:

Gentian Kallmi	Kryetar	
Ermal Lufo	Anëtar	
Andri Cerri	Anëtar	
Diana Mandia	Anëtare	
Klara Agasi	Anëtare	
Edvin Hysi	Anëtar	
Afroviti Manthjo	Anëtare	
Erjon Meka	Anëtar	
Pranvera Guma	Anëtar	
Ilir Ngresi	Anëtar	



ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE NR.3 (RIFORCIMI)

NR.	NR APLIKIMIT	KODI GIS	EMER	ATESI	MBIEMER	DS	KONKLUZIONI I AKT EKSPERTIZES	SUBJEKT PERFITUES
1	28977	22810	LULZIM	HAMDI	KAPIDANI	DS3	RIFORCIMI	PO



**ANEKSI 2. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5**


Nr.	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	MBIEMRI	KUALIFIKOHET	KONKLuzioni AKTEKSPERTIZES
1	44694	MIRELA	TOSHI	PO	PRISHJE



**ANEKSI 3. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.6**

Nr.	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	MBIEMRI	KUALIFIKOHET	KONKLuzioni AKTEKSPERTIZES
1	25223	SHKEMBOR	TILA	PO	PRISHUR ME P.V. IMTV
2	8279	ANDI	ALLIU	PO	PRISHUR ME P.V. IMTV





2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 549/prot.
6

Durrës, më 30.07.2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.93 datë 26.07.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale në njësitë administrative nr. 3, 5, 6, Bashkia Durrës, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

